

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE - KESH Sh.a.

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012

J 61817005 F

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR
31 DHJETOR 2012

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

		Viti i mbyllur më Shënime 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (I Riparaqitur)
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	81,043,747	82,589,027
Aktive afatgjata jomateriale		100	117
Aktive financiare	9	22,522,670	24,061,184
		103,566,517	106,650,329
Aktive afatshkurtra			
Inventarë	8	2,390,927	2,529,427
Aktive financiare	9	2,817,548	2,837,559
Llogari të arkëtueshme e të tjera	7	57,842,204	35,042,255
Tatimi i parapaguar mbi fitimin			410,000
Mjete monetare në arkë e bankë	10	809,437	1,602,222
		63,860,116	42,421,463
Totali i aktiveve		167,426,633	149,071,791
KAPITALI			
Kapitali aksioner dhe rezervat			
Kapitali aksioner	11	17,337,980	18,743,996
Shtese e paregjistruar kapitali	11	2,704,355	15,934,313
Reduktim i paregjistruar kapitali	11	(6,238)	(2,499,547)
Rezerva të tjera		46,551,199	46,547,416
Rezerva ligjore		1,700,213	1,700,213
Fitimi (humbja) e mbartur		11,173,374	(7,372,296)
Totali i kapitalit		79,460,884	73,054,095
DETYRIME			
Detyrime afatgjata			
Kredi dhe hua	13	37,141,138	36,996,496
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	14	601,689	868,466
Grante qeveritare	15	147,784	90,633
Detyrime të tjera afat-gjata	12	810,147	810,147
		38,700,758	38,765,742
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	12	14,222,736	13,555,371
Kredi dhe hua	13	35,042,255	23,696,584
		49,264,991	37,251,954
Totali i detyrimeve		87,965,749	76,017,697
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		167,426,633	149,071,791

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 26 Prill 2013 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Z. Halit VELAJ



Drejtor i Departamentit
Ekonomik

Z. Artur KURTI



Shefi i Sektorit të Kontabilitetit

Zj. Arjola QIRKO



KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A
 PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE
 PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2012

<i>(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)</i>	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (I Riparaqitur)
Operacionet e vijueshëm			
Të ardhura	16	24,650,745	14,109,703
Të ardhura të tjera	17	2,631,691	1,325,678
Materiale të para dhe të konsumueshme		(99,161)	(138,842)
Blerje energjie	22	(11,564,586)	(16,506,132)
Tarifë transmetimi		(2,749)	
Shpenzime personeli	18	(1,064,503)	(1,319,618)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(2,000,643)	(1,410,446)
Humbje nga rënia në vlerë			(221,528)
Shpenzime të tjera	19	(760,104)	(1,959,763)
Fitimi operativ		11,790,691	(6,120,948)
Të ardhura financiare			
Të ardhura financiare	20	469,350	612,993
Shpenzime financiare	20	(5,047,829)	(1,851,384)
Shpenzime financiare neto		(4,578,479)	(1,238,391)
Fitimi para tatimit			
		7,212,212	(7,359,339)
Kreditim i tatimit mbi fitimin	21	266,777	(9,956)
Shpenzime tatim fitimi		(1,038,921)	(3,001)
Fitimi neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm		6,440,067	(7,372,296)
Operacionet jo të vijueshëm			
Fitimi neto i periudhës nga operacionet jo të vijueshëm			
Fitimi neto i periudhës		6,440,067	(7,372,296)
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse			
Shtesë/(pakësim) në rezervën e rivlerësimit		(1,065)	45,964,408
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse			
Aksionerë të Shoqërisë		6,439,002	38,592,112
		6,439,002	38,592,112

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 26 Prill 2013 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Z. Halit VELAJ




Drejtor i Departamentit
Ekonomik

Z. Artur KURTI



Shefi i Sektorit të Kontabilitetit

Zj. Arjola QIRKO




KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2012

	Aksionerët e Shoqërisë						Totali i kapitalit
	Kapitali aksioner	Shtesë kapitali e parregjistruar	Reduktim i parregjistruar kapitali	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitim/ (Humbje) të mbartura	
Gjendja më 1 Janar 2011	1,551,778	-	(4,000)	18,681,211	933,717	15,329,937	36,492,642
Të ardhura neto për periudhën (E Riparaqitur)						(7,372,296)	(7,372,296)
Shtesë në rezervë nga rivlerësimi i asetëve				45,964,408			45,964,408
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse				45,964,408		(7,372,296)	38,592,112
Shpërndarja e rezultatit të vitit 2010	14,563,440			-	766,497	(15,329,937)	-
Zmadhim Kapitali	6,587,702			(2,156,460)			4,431,242
Ndarja e HC -eve	(3,848,291)		(1,089,532)				(4,937,823)
Ulje kapitali	(110,633)			(7,427)			(118,060)
Sistemime të parregjistruara Kapitali		15,934,313	(1,406,016)	(15,934,313)			(1,406,016)
Transaksione me pronarët	17,192,218	15,934,313	(2,495,547)	(18,098,200)	766,497	(15,329,937)	(2,030,657)
Gjendja më 31 Dhjetor 2011 (E Riparaqitur)	18,743,996	15,934,313	(2,499,547)	46,547,416	1,700,213	(7,372,296)	73,054,095
Të ardhura neto për periudhën						6,440,067	6,440,067
Sistemim i rezervës				(950)		(-116)	(1,065)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse				(950)		6,439,951	6,439,002
Shpërndarja e rezultatit të vitit 2011				35,501		(35,501)	-
Zmadhim Kapitali i parregjistruar		(13,229,958)	1,089,532			12,140,426	-
Rregjistrim në QKR i zvogëlimit të Kapitalit	(1,406,016)		1,406,016				-
Zvogëlim i parregjistruar Kapitali			(2,238)	(30,768)		793	(32,213)
Transaksione me pronarët	(1,406,016)	(13,229,958)	2,493,310	4,733	-	12,105,718	(32,213)
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	17,337,980	2,704,355	(6,238)	46,551,199	1,700,213	11,173,374	79,460,884

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 26 Prill 2013 dhe u firmosën si më poshtë:


Administratori

Z. Halit VELAJ




Drejtor i Departamentit Ekonomik

Z. Artur KURTI



Shefi i Sektorit të Kontabilitetit

Zj. Arjola QIRKO



Shënimet shpjeguese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
PASQYRA E KONSOLIDUARA E FLUKSEVE MONETARE PER VITIN E
MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2012

<i>(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)</i>	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (I Riparaqitur)
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Flukset e parasë përdorur në aktivitetet operative	23	(7,416,465)	(5,648,003)
Interesa të paguara		(1,827,028)	(1,639,078)
Tatimi i paguar mbi fitimin			(410,000)
Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet operative		(9,243,494)	(7,697,081)
Flukset e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(1,647,140)	(1,955,016)
Hua dhënë palëve të treta		(896,850)	(1,536,987)
Shlyerje të kredive nga palë të treta		2,202,192	2,405,951
MM te op. Jo te vijueshem te nxj. j.p.			(230,506)
Interesa të arkëtuara		415,424	534,005
Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet investuese		73,626	(782,552)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese			
Të ardhura nga huamarrjet		3,990,055	1,830,320
Shlyerje e huamarrjeve		(1,172,411)	(3,629,670)
Të ardhura nga grantet		64,582	14,508
Flukset neto të parasë nga aktivitetet financuese		2,882,225	(1,784,842)
Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare		(6,287,642)	(10,264,475)
Mjete monetare në fillim të periudhës kontabël		(17,683,331)	(7,418,856)
Mjete monetare në fund të periudhës kontabël	10	(23,970,973)	(17,683,331)

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 26 Prill 2013 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Z. Halit VELAJ



Drejtor i Departamentit
Ekonomik

Z. Artur KURTI



Shefi i Sektorit të
Kontabilitetit

Zj. Arjola QIRKO



1. Informacion i përgjithshëm

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a dhe Shoqëritë e kontrolluara prej saj (së bashku "KESH" ose "Grupi") u themelua si një shoqëri anonime me aksione më 31 Dhjetor 1994. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë zotëron plotësisht kapitalin aksioner të KESH-it.

Më 31 Dhjetor 2012, Grupi zotëronte kapitalin aksioner të 'KESH Security SHRSF' Sh.a. ("KESH Security") dhe "Termocentrali Vlorë" Sh.a. ("TEC Vlorë"). KESH Security u themelua më 7 Prill 2008 bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Grupit dhe është e përfshirë në sigurimin e shërbimeve të ruajtjes për Grupin. TEC Vlorë u regjistrua si një shoqëri tërësisht e kontrolluar nga Grupi në Dhjetor 2007, dhe veprimtaria kryesore e tij është prodhimi i energjisë.

KESH sh.a. aktualisht përbëhet nga 4 njësi prodhuese hidro-energjetike, KESH Security, TEC Vlorë dhe Administrata Qëndrore. Shoqëria e ka adresën zyrtare në Shqipëri. Adresa e zyrës së saj të regjistruar është Blloku Vasil Shanto, Kutia postare 259/1, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përshkruhen në detaje në politikat kontabël të më poshtme.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa çmuarjeve kritike kontabël. Gjithashtu kjo kërkon që drejtimi të përdorë gjykimin e tij në procesin e përdorimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Fushat që përfshijnë një nivel të lartë gjykimi apo kompleksiteti ose fushat ku supozimet dhe çmuarjet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare paraqiten në shënimet përkatësisht. Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2012. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2012. Të dhënat aktuale në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijë Lek ('000 LEK).

(a) Ndryshimet në politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ndryshimet e kërkesave për dhënie informacioni.

Standartet e reja, amendimet e standarteve dhe interpretimeve të paraqitura më poshtë, janë të detyrueshme për zbatim për herë të parë në pasqyrat financiare për vitin që fillon më 1 Janar 2012, por që nuk pritët të sjellin ndryshime të rëndësishme në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF 1: Hiperinflacioni i rëndë

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2011)

Ndryshimet në lidhje me inflacionin e rëndë ofron udhëzime për shoqëritë që dalin nga situata në kushtet e hiperinflacionit të rëndë ose për të rifilluar prezantimin e pasqyrave financiare sipas SNRF-ve, ose të paraqesin pasqyrat financiare sipas SNRF-ve për herë të parë.

SNRF 1: Heqja e datave fikse për adoptuesit për herë të parë

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2011)

Ndryshimet në lidhje me heqjen e datave fikse siguron lehtësim për adoptuesit për herë të parë të SNRF-ve nga rindërtimi i transaksioneve që kanë ndodhur para datës së kalimit në SNRF.

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(a) Ndryshimet në politikat kontabël (Vazhdim)

SNRF 7 :Paraqitja – Transferimi i Aktiveve Financiare

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrik 2011)

Ndryshimet në SNRF 7 rrisin kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese për transaksionet që përfshijnë transferimin e aktiveve financiare. Këto ndryshime kanë për qëllim të sigurojnë transparencë më të madhe rreth ekspozimeve të rrezikut të transaksioneve, ku një aktiv financiar është transferuar, por transferuesi ruan ende një nivel të ekspozimit të vazhdueshëm në lidhje me aktivin.

SNK 12: Tatimi i shtyrë - Rikuperimi i Aktiveve themelore

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2012)

Ndryshimet në SNK 12 sigurojnë një përjashtim nga parimi i përgjithshëm i cili përcaktohet në SNK 12 “Tatimet mbi të Ardhurat” që matja e tatimit të shtyrë duhet të pasqyrojë mënyrën në të cilën njësitë ekonomike pret të rikuperojë vlerën kontabël të një aktivi. Konkretisht ndryshimet përcaktojnë një hipotezë të kundërshtueshme që vlera kontabël e një aktivi afatgjat material të investuar që matet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në SNK 40 “Investimi në Aktivet Afatgjata Materiale”, do të mbulohet tërësisht nëpërmjet shitjes. Ndryshimet janë kryer në përgjigje të shqetësimeve se aplikimi i qasjes së përgjithshme të SNK 12 mund të jetë i vështirë apo subjektiv për aktivin afatgjat material të investuar të matur me vlerën e drejtë, sepse mund të ndodhë që njësitë ekonomike synon ta mbajë aktivin për një periudhë të pacaktuar ose të papërcaktuar kohore, gjatë se cilës ajo parashikon edhe të ardhura nga qiraja dhe vlerësimin i kapitalit.

Sipas ndryshimeve, me përjashtim nëse supozimi hidhet poshtë, matja e tatimit të shtyrë duhet të reflektojë pasojat tatimore të rimarrjes së vlerës kontabël të aktivit afatgjat të investuar, tërësisht nëpërmjet shitjes. Supozimi i shitjes kundërshtohet nëqoftëse aktivi i investuar është i amortizueshëm dhe aktivi i investuar mbahet brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit është konsumimi kryesisht i të gjitha përfitimeve ekonomike të trupëzuara në aktivin e investuar me kalimin e kohës dhe jo përmes shitjes.

Pas zbatimit të ndryshimeve, Shoqëritë të cilat mbajnë aktivin afatgjat material të investuar të kontabilizuar duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në përputhje me SNK 40, në juridiksione ku tatimi nuk është i imponuar në shitje të aktivit të investuar, nuk do të njohin më tatim të shtyre mbi diferencat e përkohshme që rrjedhin nga fitim humbjet përmes vlerës së drejtë (përveç rasteve kur supozimi është hedhur poshtë).

Kjo për shkak se nuk duhet të ketë pasojat tatimore që priten të lindin nga rikuperimi i vlerës kontabël tërësisht nëpërmjet shitjes, pavarësisht nëse njësitë ekonomike synon të përdorë aktivin për të gjeneruar të ardhura nga qiraja për një periudhë kohe para shitjes.

Për aktivin e investuar të amortizuar, zbatimi i ndryshimeve do të rezultojë në një ndryshim të politikës kontabël. Kur tatimi i shtyrë lidhur me një aktiv të investuar është përcaktuar më parë në bazë të pritjeve se aktivi do të rimerret përmes përdorimit, baza e matjes do të duhet të ndryshohet me përjashtim kur supozimi i shitjes është hedhur poshtë. Kur amendimet kërkojnë aplikim të plotë të matjes retrospektivisht dhe efekti është material, vlerat e vitit paraardhës janë të nevojshme për zbatimin e plotë retrospektiv.

Standartet e reja, amendimet e standarteve dhe interpretimeve të paraqitura më poshtë, janë të publikuara por akoma jo efektive deri në datën e leshimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë.

Shoqëria synon të adoptojë këto standarte kur ato të bëhen efektive.

Amendimet e SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” në lidhje me të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 korrik 2012)

Ndryshimi kryesor që rezulton nga këto amendime është një kërkesë për shoqëritë që të grupojnë zëra të paraqitur në “të tjera të ardhura gjithpërfshirëse” mbi bazën nëse ato janë potencialisht të riklasifikueshme në fitim ose humbje më pas (axhustimet në lidhje me riklasifikimet). Amendimet nuk adresojnë se cilat zëra janë paraqitur tek “të tjera të ardhura gjithpërfshirëse”.

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(a) Ndryshimet në politikat kontabël (Vazhdim)

Amendimet e SNK 19 “Përfitimet e Punonjësve”

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

Këto amendime eliminojnë përjasjen corridor dhe llogarisin kostot financiare mbi një bazë të financimit neto. Grupi duhet të vlerësojë impaktin që do të kenë këto ndryshime në pasqyrat financiare.

Amendimet në SNRF 1 “Adoptimi për herë të parë” mbi huatë qeveritare

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

Ky amendim trajton si do të gjykonte një adoptues për herë të parë për një kredi qeveritare me një normë interesi poshtë nivelit të tregut, gjate kalimit në SNRF. Ky amendim shton gjithashtu një përjashtim në lidhje me zbatimin retrospektiv të SNRF, e cila siguron të njëjtin lehtësim për adoptuesit për herë të parë si përgatitësit ekzistues të pasqyrave financiare sipas SNRF-ve kur kërkesa ishte përfshirë në SNK 20 në vitin 2008.

Amendimet në SNRF 7 “Instrumetat Financiarë” dhënia e informacioneve shpjeguese mbi aktivet dhe detyrimet që kompesohen

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

Amendimet për SNRF 10,11 dhe 12 për udhëzimet në lidhje me fazën tranzitore

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

Këto amendime sigurojnë lehtësim shtesë gjatë tranzicionit për SNRF 10,11 dhe 12, duke kufizuar kërkesat për të dhënë informacion krahasues duke rregulluar vetëm periudhën krahasuese paraardhëse. Për dhënien e informacioneve shpjeguese që lidhen me shoqëritë e pakonsoliduara, amendimet do të heqin kërkesat për të paraqitur informacion krahasues për periudhat përpara aplikimit për here të parë të SNRF 12.

SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara”

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

SNRF 10 paraqet duke identifikuar parimin e kontrollit si një faktor determinues nëse një i investuar duhet të përfshihet ose jo në pasqyrat financiare të konsoliduara të investitorit. Standarti siguron udhëzime shtesë për të asistuar në përcaktimin e kontrollit kur hasen vështirësi në vlerësim.

SNRF 11, ‘Marrëveshjet e përbashkëta

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

SNRF 11 është një reflektim më real i marrëveshjeve të përbashkëta duke u fokusuar në të drejtat dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në marrëveshje sesa formën ligjore të tyre.

Interesat e një njësie ekonomike në operacione të përbashkëta, të cilat rregullohen nga një marrëveshje ku operatorët e përbashkët gëzojnë të drejta për asetet dhe detyrimet që lidhen me marrëveshjen, llogariten duke u bazuar në këto të drejta dhe detyrime në raportin e përcaktuar në përputhje me marrëveshjen kontraktuale.

Interesat e një njësie ekonomike në sipërmarrje të përbashkëta të cilat rregullohen nga një marrëveshje ku sipërmarrësit e përbashkët gëzojnë të drejta mbi aktivet neto, llogariten sipas metodës së kapitalit.

SNRF 12, ‘Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në shoqëri të tjera

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

SNRF 12 përfshin kërkesat për dhënie informacioni shpjegues për të gjitha format e interesave në njësitë e tjera duke përfshirë marrëveshjet e përbashkëta, bashkëpunëtorët, etj

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(a) Ndryshimet në politikat kontabël (Vazhdim)

SNRF 13 “Matja e Vlerës së drejtë”

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

SNRF 13 siguron një burim të vetëm udhëzimesh se si matet vlera e drejtë dhe kërkesash për dhënie informacionesh shpjeguese. SNRF 13 aplikohet kur matja e vlerës së drejtë ose informacionet shpjeguese kërkohen ose lejohen nga standartet e tjera brënda SNRF – ve.

SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

SNK 27 (rishikuar në 2011) përfshin kërkesa në lidhje me pasqyrat financiare individuale.

SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta.

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013)

SNK 28 (rishikuar në 2011) përfshin kërkesat për investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta që duhet të llogariten njësoj duke ndjekur çështjet e SNRF 11.

Amendimet e SNK 32 “Kompesimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare”

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2014)

Këto ndryshime janë për udhëzimin e aplikimit të SNRF 32 “Instrumentat financiarë paraqitja” duke sqaruar disa nga kërkesat për kompesimin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare në bilancin kontabël.

SNRF 9 Instrumentat Financiare

(Efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2015)

SNRF 9 është standarti i parë i lëshuar si pjesë e një projekti më të gjerë për të zëvendësuar SNK 39. SNRF 9 ruan por thjeshton modelin e përzier të matjes dhe krijon dy kategori kryesore të matjes për aktivet financiare: koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë. Baza e klasifikimit varet nga modeli i aktivitetit të tij si dhe karakteristikat kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit financiar. Udhëzimi në SNK 39 për zhvlerësimin e aktiveve financiare dhe kontabilitetin mbrojtës vazhdon të zbatohet.

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- instrumentet derivative financiare janë matur me vlerë të drejtë
- instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet biologjike janë matur me vlerë të drejtë minus kostot e vlerësuar në pikën e shitjes
- pronat e mbajtura për qëllime investimi janë matur me vlerë të drejtë
- detyrimet nga marrëveshjet për pagesa të bazuara në aksione që shlyhen në mjete monetare janë matur me vlerë të drejtë.

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(c) Bazat e konsolidimit

Filialet janë të gjitha njësitë ekonomike (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) ndaj të cilave Grupi ka fuqi për të drejtuar politikat e përgjithshme financiare dhe operacionale çka zakonisht shoqërohet me zotërim të më shumë se gjysmës së aksioneve me të drejtë vote. Ekzistenca dhe ndikimi i të drejtave potenciale të ushtrimit të votës që janë aktualisht të ushtrueshme apo të konvertueshme merren në konsideratë kur vlerësohet kontrolli i grupit ndaj një njësie tjetër ekonomike. Filialet janë plotësisht të konsoliduara prej datës në të cilën kontrolli i transferohet Grupit. Ato nuk përfshihen në konsolidim në momentin që kontrolli ndërpritet.

Për regjistrimin në kontabilitet të blerjes nga Grupi të filialeve është përdorur metoda e blerjes. Kostoja e një blerjeje matet si vlera e drejtë e aktiveve të dhëna, instrumenteve të emetuar të kapitalit dhe detyrimeve të ndodhura ose të marra përsipër në datën e shkëmbimit, plus kostot e lidhura direkt me blerjen. Aktivitetet e blera, detyrimet dhe detyrimet e kushtëzuara të identifikueshme që merren përsipër në një kombinim biznesesh maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga shtrirja e çdo interesi të pakicës. Teprica e kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës së Grupit të aktiveve neto të identifikueshme të blera regjistrohet si emri i mirë. Nëse kostoja e blerjes është më e vogël se vlera e drejtë e aktiveve neto të filialit të blerë, diferenca njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Transaksionet brenda Grupit, balancat dhe fitimet e përcaktuara nga transaksionet midis Shoqërive të Grupit, eliminohen. Humbjet e përcaktuara gjithashtu eliminohen, por konsiderohen si tregues i rënies në vlerë të aktivitetit të transferuar. Politikat kontabël të filialeve janë ndryshuar kur është gjykuar e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri me politikat e adoptuara nga Grupi

(d) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në mijë Lekë ('000 LEK), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Grupit. Informacioni financiar i paraqitur në Lekë është përafëruar në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

(e) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykimet kritike për zbatimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm mbi shumat e regjistruara në pasqyrat financiare jepet në shënimin 5.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël paraqitur më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra të konsoliduara financiare dhe janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga njësitë e Grupit.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën përkatëse funksionale duke përdorur kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedha të huaja në datën e raportimit rikonvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së përcaktimit të vlerës së drejtë.

Kurset kryesore të këmbimit ndaj Lekut janë:

	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
1 EUR	139.59 Lek	138.93 Lek
1 USD	105.85 Lek	107.54 Lek
1 CHF	115.65 Lek	114.46 Lek
100 YEN	122.93 Lek	138.80 Lek

(b) Aktivitet afatgjata materiale

Tokat dhe ndërtesat përfshijnë kryesisht impiante energjetike dhe ndërtesa zyrash. Te gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto pakësuar më pas me zhvlerësimin dhe rënien në vlerë, përveç tokës, e cila paraqitet me kosto pakësuar me rënien në vlerë. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për përdorimin e synuar, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Programet e blera që janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjeve me të cilat lidhen kapitalizohen si pjesë e atyre pajisjeve. Drejtimi ka aplikuar vlerën e drejtë si bazë për koston e supozuar për disa zëra të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara kur Shoqëria bëri kalimin drejt SNRF-ve më 1 Janar 2006.

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Grupi do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e saj mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit për shpërndarjen e kostos së aktivitet minus vlerën e tij të mbetur përgjatë jetës së tij të dobishme si vijon :

– ndërtesa	40 – 100 vjet
– makineri dhe pajisje	10 – 65 vjet
– mjete transporti	5 vjet
– orendi, instalime dhe pajisje	4 vjet

Toka, ndërtimet në proces dhe parapagimet ndaj furnitorëve nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar çmimin e shitjes me vlerën kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (Vazhdim)

(b) Aktivet jomateriale

- *Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit*

Shpenzimet e kryera për zhvillimin e projekteve janë regjistruar si aktive të paprekshme. Sipas SNK 38 kjo lejohet vetëm nëse është e mundshme që projekti do të ketë sukses, duke konsideruar mundësinë komerciale dhe teknologjike, dhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme.

(c) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktiv rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohej me një normë skontimi para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudha të mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eliminimit të humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën e aktivit që duhej të përcaktohej, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

(d) Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(e) Inventarët

Inventarët maten me shumën më të vogël midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në parimin hyrje e parë, dalje e parë (FIFO) dhe përfshin shpenzime të ndodhura në blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit dhe të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë transferimit të tyre në vendodhjen dhe konditat ekzistuese.

Në rastin e inventarëve të prodhuar dhe punimeve në proces, kostoja përfshin një shpërndarje të caktuar të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit duke u bazuar në kapacitetin normal të aktivitetit.

Kostoja e inventarit mund të përfshijë edhe transferime nga kapitali të çdo fitimi apo humbjeje nga mbrojtje të kualifikueshme të flukseve monetare nga blerjet në monedhë të huaj të inventarit.

Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur shpenzimet e vlerësuara të përfundimit të shitjes.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (Vazhdim)

(f) Instrumentat financiarë

Grupi zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë, duke përfshirë llogari të arkëtueshme, mjete monetare, huamarrje dhe huadhënie, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat jo me vlerë të drejtë kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Grupi bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Grupit ndaj flukseve të parasë së aktivitetit financiar ose kur kompania transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontroll ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Grupi angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Grupit skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe mjetet monetare ekuivalente me to

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, depozitat në para me bankat, investime të tjera tejet likuide me maturim fillestar prej tre ose më pak muajsh.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

Huadhënie dhe huamarrje

Pas njohjes fillestare, huadhëniet dhe huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në interesin efektiv të çdo diference midis kostos dhe vlerës së riblerjes përgjatë periudhës së huamarrjes.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, duke përjashtuar ndërtimet në proces, vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën e interesit në treg në datën e raportimit.

Instrumentat financiarë janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përveç rastit kur Grupi ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

(g) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

(h) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (Vazhdim)

(i) Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i shtyrë

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, në këtë rast tatimi njihet në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumat e përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin e miratuar në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme tatimore të vlefshme që diferencat e përkohshme mund të përdoren kundrejt tyre. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

(j) Përfitimet e punonjësve

- *Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit*

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Grupi është i detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

- *Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës*

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundimin e kontratës njihen si shpenzim kur Grupi është i përkushtuar pa ndonjë mundësi realiste tërheqje ndaj një plani formal dhe të detajuar që të përfundojë kontratën përpara datës normale të daljes në pension ose të sigurojë përfitimet e përfundimit si rezultat i një oferte për të përkrahur sigurimin vullnetar. Përfitimet në përfundimin e kontratës për sigurimet vullnetare njihen si një shpenzim nëse Grupi ka bërë një ofertë për sigurimin vullnetar dhe është e mundshme që oferta do pranohet dhe numri i pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

(k) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Grupi ka një detyrim të tërthortë ligjor i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkohej flukse dalëse parash për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit.

(l) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të Grupit që rezultojnë në rritje të kapitalit gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit në tij të kontributeve të aksionerëve në kapital. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Grupit.

Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet. Kur shumat e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, Grupi i njeh të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara për furnizimin me energji. Shumat e të ardhurave nuk konsiderohen si e matshme me besueshmëri derisa nuk janë zgjidhur të gjithë kushtëzimet në lidhje me shitjen. Grupi bazohet në rezultatet historike, duke mbajtur parasysh llojin e klientit, tipin e transaksionit dhe specifikimet e çdo marrëveshjeje, për të kryer vlerësimet e veta.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (Vazhdim)*Shitja e energjisë*

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur për (i) FPP (CEZ Shpërndarje sh.a.); (ii) brenda dhe jashtë vëndit me çmime të parregulluara; (iii) energji për mbulimin e humbjeve të OST sh.a.; (iv) energji për disbalancat.

(m) Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiramarrësi klasifikohen si të qira operative. Pagesat e qirave të zakonshme (duke përjashtuar stimuluesit e vendosur nga qiramarrësi) njihen me metodën lineare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së qirasë. Shpenzimet për kestet minimale të qirase llogariten dhe evidentohen në përpjestim me kohën e maturimit të qirase, përgjate afatit të qirase, pavarësisht nga koha dhe shumat e paguar në fakt.

(n) Shpërndarja e dividendit

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Grupit si detyrim i periudhës në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

(o) Grantet qeveritare

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se grantet qeveritare do të merren dhe Grupi do të jetë në përputhje me konditat që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të njëjtën periudhë në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

(p) Riparaqitje

Grupi ka bërë disa riparaqitje në zërat e pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2011.

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

	Viti i mbyllur më Shënime 31 Dhjetor 2011	Efektet e riparaqitjes	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (I Riparaqitur)
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	82,589,027		82,589,027
Aktive afatgjata jomateriale	117		117
Aktive financiare	24,061,184		24,061,184
	106,650,329		106,650,329
Aktive afatshkurtra			
Inventarë	2,529,427		2,529,427
Aktive financiare	2,837,559		2,837,559
Llogari të arkëtueshme e të tjera	30,169,823	4,872,432	35,042,255
Tatimi i parapaguar mbi fitimin	410,000		410,000
Mjete monetare në arkë e bankë	1,602,222		1,602,222
	37,549,031	4,872,432	42,421,463
Totali i aktiveve	144,199,359	4,872,432	149,071,791

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (Vazhdim)

(p) Riparaqitje

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

		Viti i mbyllur më Shënime 31 Dhjetor 2011	Efektet e riparaqitjes	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (I Riparaqitur)
KAPITALI				
Kapitali aksioner dhe rezervat				
Kapitali aksioner		18,743,996		18,743,996
Shtese e paregjistruar kapitali		15,934,313		15,934,313
Reduktim i paregjistruar kapitali		(2,499,547)		(2,499,547)
Rezerva të tjera		46,547,416		46,547,416
Rezerva ligjore		1,700,213		1,700,213
Fitimi (humbja) e mbartur	a,b	(12,140,426)	4,768,130	(7,372,296)
Totali i kapitalit		68,285,965	4,768,130	73,054,095
DETYRIME				
Detyrime afatgjata				
Kredi dhe hua		36,996,496		36,996,496
Tatimi i shtyrë mbi fitimin		868,466		868,466
Grante qeveritare		90,633		90,633
Detyrime të tjera afat-gjata		810,147		810,147
		38,765,742		38,765,742
Detyrime afatshkurtra				
Llogari të pagueshme dhe të tjera	b	13,451,069	104,302	13,555,371
Kredi dhe hua		23,696,584		23,696,584
		37,147,653	104,302	37,251,954
Totali i detyrimeve		75,913,395	104,302	76,017,697
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		144,199,359	4,872,432	149,071,791

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

		Shënime Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011	Efektet e riparaqitjes	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (I Riparaqitur)
Operacionet e vijueshëm				
Të ardhura	a	9,237,271	4,872,432	14,109,703
Të ardhura të tjera		1,325,678		1,325,678
Materiale të para dhe të konsumueshme		(138,842)		(138,842)
Blerje energjie		(16,506,132)		(16,506,132)
Shpenzime personeli		(1,319,618)		(1,319,618)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi		(1,410,446)		(1,410,446)
Humbje nga rënia në vlerë		(221,528)		(221,528)
Shpenzime të tjera	b	(1,855,461)	(104,302)	(1,959,763)
Fitimi operativ		(10,889,078)		(6,120,948)
Të ardhura financiare		612,993		612,993
Shpenzime financiare		(1,851,384)		(1,851,384)
Shpenzime financiare neto		(1,238,391)		(1,238,391)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (Vazhdim)

(p) Riparaqitje (Shumat janë të shprehura në mijë Lek)	Viti i mbyllur më Shënime 31 Dhjetor 2011	Efektet e riparaqitjes	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2011 (I Riparaqitur)
Fitimi para tatimit	(12,127,469)	4,768,130	(7,359,339)
Kreditim i tatimit mbi fitimin	(9,956)		(9,956)
Shpenzime tatim fitimi	(3,001)		(3,001)
Fitimi neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm	(12,140,426)	4,768,130	(7,372,296)
Operacionet jo të vijueshëm			
Fitimi neto i periudhës nga operacionet jo të vijueshëm			
Fitimi neto i periudhës	(12,140,426)	4,768,130	(7,372,296)

(a) *Llogari të arkëtueshme e të tjera*

Në bazë të legjislacionit në fuqi dhe dispozitave të kontratës dypalëshe, KESH sh.a. ka detyrim ligjor të furnizojë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes - CEZ Shpërndarje sh.a. me çmim të rregulluar për sasinë e energjisë elektrike që i nevojitet për konsumin e klientëve tariforë.

Në Raportin Vjetor të Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2011, publikuar në Mars 2012, u saktësua bilanci i përgjithshëm energjetik vjetor 2011 (në të cilin merren në konsideratë përveç prodhimit edhe importet, shkëmbimet, konsumi dhe humbjet e energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar). Nga të dhënat e publikuara në këtë raport rezulton se gjatë vitit 2011 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - CEZ Shpërndarje sh.a. është furnizuar me çmim të rregulluar nga KESH sh.a. përtej detyrimit ligjor që KESH sh.a. ka ndaj Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - CEZ Shpërndarje sh.a.; detyrim i cili është i barabartë vetëm me sasinë e energjisë elektrike që i korrespondon sasisë së energjisë që CEZ Shpërndarje sh.a. i faturon konsumatorëve tariforë. Borxhi energjetik që rezultoi nga viti 2011 është 549,240 MWh. Gjatë vitit 2012 KESH sh.a. për këtë sasi energjie ka prerë një faturë rregulluese për diferencën e çmimit që rezulton ndërmjet çmimit të energjisë së prokuruar në tregun e parregulluar me atë të miratuar nga ERE për vitin 2011. Efekti i riparaqitjes rezulton në rritje të të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike, për pasojë dhe e uljes së humbjes së vitit 2011 për Lek 4,872,432 mijë si dhe në rritje të llogarive të arkëtueshme e të tjera për Lek 4,872,432 mijë.

(b) *Llogari të pagueshme dhe të tjera*

Gjatë vitit 2012, shoqërisë Tec Vlorë sh.a. i është ekzekutuar nga Përmbartimi Urdhëri i Ekzekutimit të Vendimit të Formës së Prerë të Gjykatës për humbjen e gjyqit me shoqërinë Kastpetrol në shumën Lek 104,302 mijë. Duke qënë se si humbje nuk i takon periudhës ushtrimore 2012 ajo është riparaqitur në periudhën respektive. Efekti i riparaqitjes rezulton në rritje të shpenzimeve të tjera, për pasojë dhe e rritjes së humbjes së vitit 2011 për Lek 104,302 mijë si dhe në rritje të llogarive të pagueshme dhe të tjera për Lek 104,302 mijë.

(c) *Fitim/(Humbje) të mbartura*

Efekti total i riparaqitjes në fitim/(humbjet) e mbartura është Lek 4,768,130 mijë.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda Grupit është realizuar për rreziqet financiare (kredia, tregu, monedha, likuiditeti dhe norma e interesit), rrezikun operacional (siç është rreziku mjedisor) dhe rrezikun ligjor. Objektivat kryesore të funksionit të menaxhimit të rrezikut janë përcaktimi i kufijve të rrezikut dhe sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe atij ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar këto rreziqe.

Zhvillimet aktuale

Grupi vepron në kushtet e një krize ekonomike dhe financiare globale dhe që zhvillohet në mënyrë dinamike. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në pasoja negative mbi pozicionin financiar dhe ekonomik të Grupit. Drejtimi i Grupit kryen monitorim të rregullt mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe mbi zhvillimin e tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këto, menaxhimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve si dhe kërkon të implementojë masa të përshtatshme në lidhje me kredinë, tregun (kryesisht normat e interesit), dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, duke mbajtur një pozicion kapital dhe likuid të qëndrueshëm Grupi i përgjigjet sfidave të tregut.

4.1 Rreziku i kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë i cili është rreziku që një palë në një instrument financiar të shkaktojë një humbje financiare ndaj palës tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Ekspozimi kryesor i Grupit ndaj rrezikut të kredisë vjen si pasojë e llogarive të arkëtueshme e të tjera Kreditë e marra nga Grupi financojnë projekte që do të rezultojnë në aktive që do të materializohen ose janë materializuar në KESH, OST, ose CEZ Shpërndarje dhe në një rast të tillë marrveshja kryesore e kredisë në të cilën Grupi dhe njësitë financuese kanë hyrë është ndarë me tej në nën-marrveshje kredie midis Grupit dhe OST ose CEZ Shpërndarje.

Ekspozimi maksimal i Grupit ndaj rrezikut të kredisë sipas kategorisë së instrumentit financiar dhe sipas kategorisë së aktiveve para kolateralit dhe përmirësimeve të tjera të kredisë është si vijon:

<i>Në mijë Lek</i>	2012	2011
<i>Hua dhe llogari të arkëtueshme</i>		
Mjete monetare në bankë	809,101	1,177,023
Llogari të arkëtueshme		
- Klientë familjarë	17,574,517	17,574,590
- Shoqëri private	36,106,727	13,754,980
- Njësi të kontrolluara nga shteti	369	369
Hua dhe llogari të arkëtueshme	25,340,218	26,898,743
Llogari të arkëtueshme nga punonjësit	39,135	38,739
Llogari të arkëtueshme në lidhje me çështjen “Jacobsen”	168,173	168,173
Llogari të arkëtueshme nga Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike	862,121	862,121
TVSH		773,825
Të tjera	3,091,163	1,869,458
Ekspozimi total ndaj rrezikut të kredisë	83,991,523	63,118,021

4.1.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të kredisë sepse është e mundur që klientët ose huamarrësit të dështojnë të shlyejnë detyrimet e tyre financiare. Grupi strukturon nivelet e rrezikut të ndërmarrë të kredisë duke vendosur kufij në shumën e pranuar të rrezikut nga palët e tjera apo grupe palësh të tjera. Kufijtë e niveleve të rrezikut të kredisë aprovohen rregullisht nga drejtuesit. Këto rreziqe monitorohen periodikisht dhe janë objekt i një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (Vazhdim)

4.1.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë (Vazhdim)

Për më tepër, rreziku i kredisë që lidhet me marrëveshjet e kredisë të Grupit menaxhohet dhe monitorohet mbi bazën e nën-marrëveshjeve të mëtejshme të kredisë mes Grupit dhe përfituesve të projekteve të huaja të financimit. Këto marrëveshje përfshijnë kushte dhe angazhime të cilat ndihmojnë Grupin në monitorimin dhe minimizimin e rrezikut të kredisë. Këto angazhime analizohen dhe monitorohen rregullisht siç kërkohet nga marrëveshja origjinale e kredisë.

4.1.2 Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj përqendrimit të rrezikut të kredisë. Drejtuesit monitorojnë përqendrimin e rrezikut të kredisë, por ndeshin vështirësi në zbatimin e praktikës më të mirë të politikave të manaxhimit mbi ekspozimin e Grupit ndaj këtij rreziku përmes diversifikimit të portofolit të kredisë. Kjo për shkak se grupi është i detyruar të furnizojë me energji si konsumatorët finalë me tarifë ashtu edhe Furnizuesin me Pakicë të Sektorit Publik (FPSP) nëpërmjet Furnizuesit me Shumicë të Sektorit Publik (FSHSP) sipas modelit të tregut. Në këto rrethana, masat për diversifikim janë të vështira për t'u zbatuar. Në rastin e shitjes së energjisë nga FSHSP tek FPSP përqendrimi i rrezikut është tepër i lartë duke qenë se ka vetëm një klient. Grupi po shqyrton përdorimin e instrumenteve financiarë për zvogëlimin e këtij rreziku.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut (çmimet e mallrave të energjisë), kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit Grupi është i ekspozuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për ndryshime të ardhshme të çmimeve ose normave të tregut dhe përbërjes së aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Grupit.

4.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen nga fakti se të ardhurat e Grupit dhe shumica e huave dhe llogarive të arkëtueshme janë të shprehura në Lekë, ndërkohë që një pjesë e madhe e kredive të grupit janë të shprehura në monedha të huaja (kryesisht Euro, Yen Japonez dhe Dollarë Amerikan). Rreziku është që vlera e monedhës së flukseve të parasë nga shlyerja e kredive dhe interesit përkatës, si dhe nga pagesa e faturave për energjinë e importuar, do të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve në kurset e këmbimit të cilat mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Grupit.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e grupit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të monedhave të huaja në datën e bilancit:

Në mijë Lek	Më 31 Dhjetor 2012			Më 31 Dhjetor 2011		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
LEK	51,760,162	(33,328,880)	18,431,282	35,889,380	(17,162,214)	18,727,166
EUR	22,426,521	(38,608,550)	(16,182,029)	16,907,726	(42,440,661)	(25,532,935)
USD	1,630,952	(6,950,705)	(5,319,752)	1,892,074	(6,719,682)	(4,827,608)
YEN	3,343,499	(3,810,652)	(467,152)	3,846,372	(4,331,979)	(485,607)
CHF	1,402,373	(2,249,142)	(846,768)	1,500,204	(2,226,892)	(726,687)
Të tjera	3,428,351	(2,268,348)	1,160,003	3,507,464	(2,177,169)	1,330,295
Totali	83,991,859	(87,216,276)	(3,224,417)	63,543,220	(75,058,597)	(11,515,377)

Analiza e mësipërme përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare. Investimet në kapital dhe aktive jo-monetare nuk konsiderohet të sjellin ndonjë rrezik material të kursit të këmbimit.

Me qëllimin për të optimizuar koston e financimit, në disa raste, Grupi ka marrë kredi në monedhë të huaj, kryesisht në Dollarë Amerikan, Euro dhe Yen Japonez.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**4.2 Rreziku i tregut (vazhdim)****4.2.2 Rreziku i normës së interesit**

Grupi merr hua në rrjedhën normale të biznesit për financimin e veprimtarisë së tij. Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit sepse vlera e drejtë e kredive me normë fikse si dhe flukset e parasë prej kredive me normë të ndryshueshme do të luhatet sipas luhatjeve në normat e interesit.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Grupit ndaj rreziqeve të normës së interesit. Tabela paraqet shumat e totale të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit të kategorizuara sipas datës më të hershme midis datës së riqimit të interesit kontraktual dhe datës së maturimit.

<i>Në mijë Lekë</i>	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2012				
Totali i aktiveve financiare monetare	61,469,189	7,783,615	14,739,055	83,991,859
Totali i detyrimeve financiare monetare	(49,264,991)	(19,227,412)	(18,723,874)	(87,216,276)
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj interesit më 31 Dhjetor 2012	12,204,199	(11,443,797)	(3,984,819)	(3,224,417)
31 Dhjetor 2011				
Totali i aktiveve financiare monetare	39,482,036	10,640,917	13,420,267	63,543,220
Totali i detyrimeve financiare monetare	(37,251,955)	(21,916,818)	(15,889,825)	(75,058,597)
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj interesit më 31 Dhjetor 2011	(2,230,081)	(11,275,901)	(2,469,558)	(11,515,377)

4.2.3 3 Rreziqe të tjera të çmimeve

4.2.3.1 Çmimet e instrumenteve të kapitalit

Grupi nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të instrumenteve të kapitalit pasi nuk mban aktive financiare që të përfshijnë instrumente të kapitalit në datën e bilancit. Nuk është politikë e Grupit të blejë instrumente të tillë dhe të ekspozohet ndaj rrezikut të çmimit lidhur me lëvizjet në indekset e tregut të kapitalit.

4.2.3.2 Çmimet e energjisë

Duke filluar nga data 1 Janar 2012, ERE ka aprovuar çmime të reja konsumi për energjinë për periudhën rregullatore nga data 1 Janar 2012 deri 31 Dhjetor 2014. Këto çmime janë objekt rishikimi me bazë vjetore brenda operatorëve të tregut të energjisë. Brenda kontekstit të modelit të ri të tregut, KESH sh.a. (FPSH & KESH Gen) do të furnizojë CEZ Shpërndarje sh.a. dhe OST sh.a. me çmime energjie të vendosura nga ERE.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike tek OST sh.a. i aprovuar nga ERE gjatë vitit 2012 ishte Lek 1.00 për kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike tek CEZ Shpërndarje sh.a., i aprovuar nga ERE gjatë vitit 2012 ishte Lek 2.2 për kWh .

Me vendimin nr.145, datë 07.12.2011 ERE miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike tek CEZ Shpërndarje sh.a. Lek 2.83 për kWh, për periudhën rregullatore nga data 1 Janar 2012 deri 31 Dhjetor 2014. Me vendimin nr.87, datë 29.06.2012 ky çmim u rishikua dhe u bë Lek 2.20 për kWh, duke i shtrirë efektet financiare që nga 1 Janari 2012.

Gjatë vitit 2012 kanë ndodhur ndryshime në “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike” dhe përkatësisht me vendimin nr.23, datë 24.02.2012 ERE miratoi mekanizmin e kompesimit financiar të disbalancave, i cili u rishikua me vendimin nr.93, datë 16.07.2012.

Çdo sasi tjetër energjie, e cila nuk përfshihet në detyrimin sipas modelit të tregut për furnizimin e CEZ Shpërndarje sh.a. dhe OST sh.a. është subjekt i çmimeve të tregut sipas marrëveshjeve respektive të shitjes.

Për të menaxhuar rrezikun, Shoqëria optimizon aktivitetet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të pozicionit të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme të tregjeve lokale në të cilat ajo operon. Politika nuk nënkupton mbrojtjen e një pjese të ekspozimit.

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të çmimeve të energjisë në prokurimin e energjisë dhe aktivitetet e ngjashme sepse kosto e prokurimit të energjisë për të përmbushur nevojat e konsumatorëve të saj, ndryshon së bashku me çmimet e shitjes me shumicë. Rreziku është kryesisht në faktin që çmimet e tregut për energji do të ndryshojnë midis kohës në të cilën çmimet e shitjes janë fikse apo tarifatat janë të përcaktuara dhe kohës në të cilën përcaktohet kosto e prokurimit përkatës, duke zvogëluar në këtë mënyrë marzhet e pritshme apo duke rezultuar në shitje pa fitim.

Paparashikueshmëria e çmimeve të energjisë, veçanërisht me pasigurinë e regjimeve të ardhshme të tregtisë, vështirëson llogaritjen e parashikimeve të besueshme për të mbështetur vendimet për investime duke çuar në kthyeshmëri potenciale më të vogël se ajo e pritshme.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që njësia të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Grupi është i ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndeshura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga drejtuesit e Grupit. Drejtuesit monitorojnë çdo ditë, javë dhe muaj parashikimet periodike të flukseve të parasë së Grupit.

Procesi i adoptuar nga drejtuesit për menaxhimin e likuiditetit përfshin edhe vendosjen e kufizimeve ndaj degëve për shpenzimet në lidhje me aktivitetet e përditshme si shërbimet, furnizimet si dhe për investimet, shtyrjen e pagesave ndaj disa kreditorëve ose riskedulimin e marrëveshjeve midis palëve dhe parashikimin e pagesave të kredive duke siguruar që këto të jenë të mbuluara, përdorimin e Fondit të Balancimit, etj.

Tabela që vijon tregon detyrimet sipas maturimit të tyre të kontraktuar. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse kontraktuale të paskontuara të parasë, duke përfshirë pagesat e kredive.

Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke iu referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e bilancit.

Analiza e vjetërsisë së detyrimeve financiare më 31 Dhjetor 2012 është si vijon:

Detyrimet më 31 Dhjetor 2012	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Llogari të pagueshme e të tjera	14,222,736			14,222,736
Kredi dhe hua	35,042,255	19,227,412	17,913,727	72,183,394
Detyrime të tjera afat-gjata			810,147	810,147
Totali i pagesave të ardhshme	49,264,991	19,227,412	18,723,874	87,216,276

Detyrimet më 31 Dhjetor 2011	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Llogari të pagueshme e të tjera	13,555,371			13,555,371
Kredi dhe hua	23,696,584	21,916,818	15,079,678	60,693,080
Detyrime të tjera afat-gjata			810,147	810,147
Totali i pagesave të ardhshme	37,251,955	21,916,818	15,889,825	75,058,597

4.4 Vlerat e drejta

Vlera e drejtë është shuma për të cilën mund të shkëmbehet një instrument financiar në një transaksion të zakonshëm mes palëve të mirëinformuara, e që nuk përbën një shitje të detyruar ose likuidim, dhe përfaqësohet më së miri nga një çmim i vlerësuar në një treg aktiv.

4.4.1 Aktivet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e huave dhe llogarive të arkëtueshme supozohet se është e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se ato janë instrumente afat-shkurtër që nuk mbartin interes.

4.4.1 Detyrime të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e detyrimeve të ripagueshme në të parë supozohet se është shumë e përafërt me vlerën kontabël. Shumat e ardhshme të pagueshme skontohen me norma që variojnë nga 3,36% në vit në 3,94% në vit (2011: nga 3,43% në vit në 5,05% në vit), në varësi të maturimit dhe monedhës në të cilën është shprehur detyrimi. Vlerat kontabël të llogarive të pagueshme e të tjera janë të përafërta me vlerat e tyre të drejta.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.5 Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Grupit në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e Grupit për vijimësi të biznesit me qëllim të mundësimin të kthyeshmërisë për aksionarët dhe të përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit. Grupi mund të përcaktojë shumën e dividendëve të paguar, kthyeshmërinë e kapitalit ndaj aksionarëve, të emetojë aksione të reja apo të shesë aktive për të reduktuar huamarrjen me qëllim që të ruajë apo për të ndryshuar strukturën e kapitalit.

Ashtu si ndodh në industri të tjera, Grupi monitoron kapitalin në bazë të raportit të borxhit. Ky raport llogaritet si total i detyrimeve përmbi totalin e kapitalit nën administrim. Grupi vlerëson se totali i kapitalit nën administrim është i barabartë me kapitalin siç tregohet në bilancin kontabël të konsoliduar. Grupi nuk ka kërkesa nga legjislacioni vendas në lidhje me kapitalin.

5. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë të bazuara në eksperiencën e kaluar dhe në faktorë të tjerë, që përfshijnë ngjarje që priten të ndodhin në të ardhmen. Këto vlerësime dhe gjykime mendohet të jenë të arsyeshme në rrethanat e dhëna.

Grupi bën vlerësime dhe supozime që lidhen me të ardhmen. Këto vlerësime kontabël, teorikisht, rrallë do të bazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një korigjim material të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar paraqiten më poshtë.

(a) *Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë*

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë të cilët nuk janë tregtuar në një treg aktiv (p.sh. huatë ndaj punonjësve dhe kreditë) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Grupi përdor gjykimin e tij për të zgjedhur një shumëllojshmëri metodash dhe për të bërë supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet ekzistuese të tregut në çdo datë bilanci. Për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk tregtohen në tregje aktive, Grupi përdor analizën e skontimit e flukseve të parasë.

(b) *Aktive të qëndrueshme të trupëzuara*

Drejtuesit e Grupit përcaktojnë jetëgjatësinë e pritshme dhe normat e zhvlerësimit, lidhur me aktivet e qëndrueshme të zotëruara. Ky vlerësim bazohet në ciklin e projektuar të jetës së aktivitetit. Ai mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e tregut. Këto ndryshime në jetën e aktiveve, mund të çojnë në rregullime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël neto.

(c) *Rënia në vlerë e aktiveve financiare (huave dhe llogarive të arkëtueshme)*

Grupi bazohet në udhëzimet e SNK 39 për të përcaktuar se kur një aktiv financiar është i rënë në vlerë. Ky përcaktim kërkon një gjykim të rëndësishëm. Për të gjykuar mbi të, Grupi vlerëson, midis faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe nivelin në të cilin vlera e drejtë e një investimi është më e vogël se kosto e tij dhe flukset operative dhe financiare të parasë.

Shuma e rënies në vlerë dhe llogaritë përkatëse të arkëtueshme paraqiten në shënimin 7. Rishqyrtimi i rënies në vlerë të llogarive të arkëtueshme në vitet e ardhshme mund të çojë në korigjime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

6. Aktive afatgjata materiale

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Orendi, instalime dhe pajisje	Ndërtime në proces dhe paradhënie ndaj furnitorëve	Totali
01 Janar 2011	1,260,692	20,427,701	12,068,152	180,480	135,453	13,971,349	48,043,827
Riklasifikime per efektet e rivleresimit	(431)	17,222	(17,346)	(116,834)	(71,668)	-	(189,057)
01.01.2011 pas riklasifikimeve	1,260,261	20,444,923	12,050,806	63,645	63,786	13,971,349	47,854,770
Efektet e rivleresimit	633,523	73,993,844	4,204,733	3,052	(13,826)	-	78,821,326
Vlera bruto pas rivleresimit	1,893,785	94,438,767	16,255,539	66,697	49,960	13,971,349	126,676,096
01.01.2011							
Axhustim i efektit te rivleresimit	-	450	30,687	4,323	362	-	35,823
Shtesa blerje te reja	-	52,367	440,481	203,806	41,138	1,217,224	1,955,016
Shtesa kontribut ne kapital	19,899	154,615	20	6,213	-	-	180,747
Ndarja e HC Ulez & Shkopet	(20,169)	(6,255,420)	(1,638,158)	(6,446)	(5,139)	(88,728)	(8,014,060)
Ndarja e HC Bistrice 1 & 2	(505,799)	(3,655,139)	(2,159,649)	(6,415)	(5,474)	(878,475)	(7,210,950)
Ndarja e HC Lanabregas	(26,051)	(159,953)	(127,126)	(1,883)	(674)	-	(315,687)
Transferim Petrol Alba	-	(450)	(12,429)	(105)	-	-	(12,984)
Nxjerrje jashte bilanci e magazinave	(195,199)	(325,244)	-	-	-	-	(520,443)
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	(8,621)	(406)	-	-	(9,027)
Transferime	-	56,563	66,447	7,842	195	(122,324)	8,723
Pakesime te tjera	-	-	(31,818)	(11,341)	73	-	(43,085)
31 Dhjetor 2011	1,166,466	84,306,556	12,815,375	262,287	80,441	14,099,045	112,730,169
Axhustim i efektit te rivleresimit	-	-	(1,403)	-	-	-	(1,403)
Shtesa blerje te reja	-	61,529	451,502	32,270	3,676	615,386	1,164,362
Shtesa kontribut ne kapital	-	-	-	3,220	-	-	3,220
Shtesa te tjera	-	-	20,692	426	1,933	-	23,051
Transferim i investimit tek Tec Vlore & OST	-	2,597,600	10,550,810	-	-	(13,450,682)	(302,271)
Transferim Petrol Alba	-	-	(1,370,874)	(245)	(181)	-	(1,371,300)
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashte bilanci e aseteve	(834)	(45,679)	-	-	-	-	(46,513)
Transferime	-	131,826	(18,531)	2,891	1,420	(123,353)	(5,747)
Pakesime te tjera	-	-	(12,883)	(18,242)	(346)	(179,343)	(210,814)
31 Dhjetor 2012	1,165,632	87,051,831	22,434,688	282,607	86,943	961,054	111,982,754
Zhvlertesimi i akumuluar							
01 Janar 2011	(294)	(2,925,933)	(3,872,270)	(118,996)	(76,892)	-	(6,994,385)
Riklasifikime per efektet e rivleresimit	272	(2,952)	3,380	116,993	75,839	-	193,533
Amortizimi i Akumuluar pas riklasifikimeve 01.01.2011	(22)	(2,928,885)	(3,868,889)	(2,003)	(1,054)	-	(6,800,853)
Efektet e rivleresimit	22	(25,985,217)	(721,518)	-	0	-	(26,706,713)
Amortizimi i Akumuluar pas rivleresimit 01.01.2011	0	(28,914,102)	(4,590,407)	(2,003)	(1,054)	-	(33,507,566)
Axhustim i efektit te rivleresimit	-	(28)	(10)	(105)	-	-	(143)
Amortizimi i vitit	-	(970,481)	(386,507)	(34,315)	(19,122)	-	(1,410,425)
Shtesa kontribut ne kapital	-	(75)	(20)	(2,448)	-	-	(2,543)
Ndarja e HC Ulez & Shkopet	-	3,339,283	371,048	859	651	-	3,711,842
Ndarja e HC Bistrice 1 & 2	-	425,150	290,977	737	735	-	717,600
Ndarja e HC Lanabregas	-	103,055	25,684	251	109	-	129,099
Transferim Petrol Alba	-	28	10	105	-	-	143
Nxjerrje jashte bilanci e magazinave	-	229,502	-	-	-	-	229,502
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	38	-	-	38
Transferime	-	-	1,216	(10,073)	134	-	(8,723)
Pakesime te tjera	-	-	-	15	19	-	34
31 Dhjetor 2011	0	(25,787,667)	(4,288,009)	(46,938)	(18,527)	-	(30,141,141)
Axhustim i efektit te rivleresimit	-	-	14	-	-	-	14
Amortizimi i vitit	-	(1,013,251)	(921,386)	(45,441)	(20,548)	-	(2,000,625)
Shtesa kontribut ne kapital	-	-	-	(2,222)	-	-	(2,222)
Shtesa te tjera	-	-	-	-	-	-	-
Transferim Petrol Alba	-	-	1,161,221	49	45	-	1,161,316
Nxjerrje jashte bilanci e aseteve	-	14,300	-	-	-	-	14,300
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Transferime	-	-	5,671	199	3	-	5,873
Pakesime te tjera	-	-	12,472	10,941	66	-	23,479
31 Dhjetor 2012	0	(26,786,618)	(4,030,016)	(83,412)	(38,961)	-	(30,939,007)
Vlera kontabël më:							
1 Janar 2011	1,893,785	65,524,665	11,665,132	64,695	48,906	13,971,349	93,168,531
31 Dhjetor 2011	1,166,466	58,518,888	8,527,366	215,349	61,914	14,099,045	82,589,028
1 Janar 2012	1,166,466	58,518,888	8,527,366	215,349	61,914	14,099,045	82,589,028
31 Dhjetor 2012	1,165,632	60,265,212	18,404,672	199,195	47,982	961,054	81,043,747

Në Aktive afatgjata materiale hyjnë mjetet e punës si : Tokat, trojet, ndërtesat, makinertë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet informatike, pajisjet e zyrave, etj.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

Aktivitet afatgjatë materiale më 31 Dhjetor 2012 përfshijnë aktive me një vlerë prej 81,043,747 mijë. Vlera e tyre, si shpenzim shumë vjeçar është shpërndarë midis ushtrimeve vjetore, në përpjestim të drejtë me konsumin e tyre ekonomik të realizuar në çdo vit përkatës, përjashtim nga amortizimi është bërë vetëm tek toka.

Nuk ka ndonjë aktiv të lënë si kolateral deri me 31 Dhjetor 2012.

7. Llogari të arkëtueshme

	2012	2011
Llogari të arkëtueshme	76,774,467	54,422,793
Minus: provizioni për rënien në vlerë	(23,092,854)	(23,092,854)
Llogari të arkëtueshme – neto	53,681,613	31,329,939
Llogari të arkëtueshme nga punonjësit	39,135	38,739
Llogari të arkëtueshme nga çështja “Jacobsen”	168,173	168,173
Llogari të arkëtueshme nga Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike (“SHKEE”)	862,121	862,121
TVSH		773,825
Të tjera	3,091,163	1,869,458
	57,842,204	35,042,255
Llogaritë e arkëtueshme mund të ndahen më tej në:		
Familjare	40,667,371	40,667,444
Shoqëri private	36,106,727	13,754,980
Njësi të kontrolluara nga shteti	369	369
	76,774,467	54,422,793

Grupi nuk ka njohur humbje shtesë për rënien në vlerë të llogarive të tij të arkëtueshme gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2012. Llogaritë e arkëtueshme të Grupit janë vendosur si kolateral për huatë e marra nga bankat.

Instrumentat financiarë sipas kategorisë

Politikat kontabël për instrumentet financiarë janë zbatuar ndaj zërave të mëposhtëm:

	2012	2011
Hua dhe të arkëtueshme		
Aktive financiare	25,340,218	26,898,743
Llogari të arkëtueshme e të tjera	57,842,204	35,042,255
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	809,437	1,602,222
Totali	83,991,859	63,543,220
Detyrime financiare		
Llogari të pagueshme e të tjera	14,222,736	13,555,371
Kredi dhe hua	72,183,393	60,693,080
Detyrime të tjera	810,147	810,147
Totali	87,216,276	75,058,598

8. Inventarë

	2012	2011
Materiale të para	1,272,754	1,390,499
Lëndë djegëse	1,118,172	1,138,927
Produkt i gatshëm		
	2,390,927	2,529,427

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
 Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2012
 (Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

9. Aktive financiare

	2012	2011
Aktive afat-gjata		
Hua ndaj palëve të treta	22,493,072	24,028,489
Hua ndaj punonjësve	29,598	32,695
	22,522,670	24,061,184
Aktive afat-shkurtra		
Hua ndaj palëve të treta	2,813,446	2,832,452
Hua ndaj punonjësve	4,102	5,107
	2,817,548	2,837,559
	25,340,218	26,898,743

Aktivitetet financiare më 31 Dhjetor 2012 dhe 31 Dhjetor 2011 përfshijnë kredi të dhëna OST sh.a., CEZ Shpërndarje sh.a. dhe EPCG sipas marrëveshjeve respektive dhe kredi të dhëna punonjësve të Grupit.

10. Mjete monetare në arkë e bankë

	2012	2011
Arka	182	261
Banka	809,101	1,177,023
Para në udhëtim	154	154
Mjete monetare të ngurtësuara BG		267,901
Mjete monetare të ngurtësuara LC		156,883
	809,437	1,602,222

Mjetet e ngurtësuara monetare për vitin 2011 përfaqësojnë depozita si garanci kundrejt pagesave ndaj letrave të kredisë të krijuara në favor të furnitorëve të huaj si dhe garanci bankare për furnitorët e energjise elektrike. Këto garanci bankare janë mbyllur gjatë vitit 2012. Për qëllime të pasqyrës së flukseve të parasë, mjetet monetare në arkë e bankë përfshijnë si vijon:

	2012	2011
Mjete monetare ne arkë dhe bankë	809,437	1,602,222
Mjete monetare të ngurtësuara BG		(156,883)
Mjete monetare të ngurtësuara LC		(267,901)
Overdrafte bankare	(24,780,410)	(18,860,768)
	(23,970,973)	(17,683,331)

Overdraft-et janë pjesë e kredive bankare afat-shkurtra në shumën 24,780,410 Lek (2011: 18,860,768 Lek) (Shënimi 13).

11. Kapitali aksioner dhe rezervat

	Totali kapitalit aksioner të regjistruar	Shtesa të kapitalit aksioner të paregjistruar	Pakësim i kapitalit aksioner të paregjistruar	Totali i kapitalit aksioner
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	1,551,778	-	(4,000)	1,547,778
Shpërndarja e rezultatit te vitit 2010	14,563,440			14,563,440
Zmadhim Kapitali	6,587,702			6,587,702
Ndarja e HC -eve	(3,848,291)		(1,089,532)	(4,937,823)
Ulje kapitali	(110,633)			(110,633)
Sistemime të paregjistruara Kapitali		15,934,313	(1,406,016)	14,528,297
Gjendja më 31 Dhjetor 2011	18,743,996	15,934,313	(2,499,548)	32,178,761
Zmadhim kapitali i parregjistruar		(13,229,958)	1,089,532	(12,140,426)
Zvogëlim kapitali	(1,406,016)		1,406,016	1,406,016
Zvogëlim kapitali			(2,238)	(2,238)
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	17,337,980	2,704,355	(6,238)	20,036,097

Numri total i aksioneve të autorizuara të cilat janë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit në datën 31.12.2012 është 17,337,980 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Të gjitha aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara.

Gjatë vitit 2012 kapitali i shoqërisë ka pësuar ndryshimet si më poshtë:

- Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr.248 dt. 19.03.2012 “Për zvogëlimin e kapitalit të KESH sha”, është regjistruar në QKR në datë 03.04.2012 zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën 1,406,016 mijë lekë.
- Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr.73 dt. 30.01.2013 “Për zmadhimin e kapitalit të KESH sha” si rezultat i përfshirjes në kapital të efekteve të sistemimit të marrëdhënies me shoqëritë Hec Ulëz & Shkopet sh.a., Hec Bistrica 1 & 2 sh.a., Hec Lanabregas sh.a., si dhe sistemimit të rezervave të rivleresimit nga viti 2003 është regjistruar në kontabilitet zmadhimi i kapitalit të shoqërisë 2,704,355 mijë lekë në postin shtesë e parregjistruar kapitali, si dhe është bërë mbulimi i humbjes së vitit 2011 në shumën 12,140,426 mijë lekë. Rregjistrimi në QKR është kryer në datën 20.02.2013.
- Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 133 dt. 28.02.2013 “Për zvogëlimin e kapitalit të KESH sha” për vlerën e objekteve “Oficina Shkodër ” në administrim të HEC Koman, “Oficina Shkodër ” në administrim të HEC Vau i Dejës dhe objektin “Hoteli i Punëtorëve ” Bistricë në administrim të Aparatit KESH është regjistruar në kontabilitet ndryshimi i kapitalit të shoqërisë në postin pakësim i paregjistruar kapitali për vlerën 2,238 mijë lekë. Rregjistrimi në QKR është kryer në datën 09.03.2013.

12. Llogari të pagueshme e të tjera

	2012	2011
Llogari të pagueshme	6,110,286	8,388,659
Llogari të pagueshme ndaj personelit	69,034	65,615
TVSH e pagueshme	2,600,367	
Sigurimet shoqërore dhe tatime të tjera	62,778	47,052
Tatim Fitimi	627,584	233
Llogari të pagueshme ndaj SHKEE	236,928	236,928
Dividendë të pagueshëm	112,090	119,391
Llogari të pagueshme dhe të tjera për tu sistemuar	1,879,720	1,879,720
Të tjera	3,334,095	3,627,920
	15,032,883	14,365,518

13. Kredi dhe hua

	2012	2011
Afat-gjata		
Kredi dhe hua bankare	23,148,125	24,197,629
Hua nga qeveria	13,993,014	12,798,867
	37,141,138	36,996,496
Afat-shkurtra		
Kredi dhe hua bankare	32,934,332	22,370,474
Hua nga qeveria	2,107,923	1,326,110
	35,042,255	23,696,584
Totali i kredive dhe huave	72,183,394	60,693,080

Totali i huave përfshin huatë dhe kreditë nga bankat dhe qeveria. Huatë nga bankat janë siguruar me garanci nga Qeveria e Shqipërisë.

Ekspozimi i kredive dhe huave të Grupit ndaj ndryshimeve të normës së interesit dhe datave të kontraktuara të riçimit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2012				
	EUR	USD	CHF	YEN	LEK
Kredi dhe hua bankare	3,64%	3,94%	3,36%	3,59%	-
Hua nga qeveria	3,64%	3,94%	3,36%	3,59%	-
	31 Dhjetor 2011				
	EUR	USD	CHF	YEN	LEK
Kredi dhe hua bankare	5,05%	4,23%	3,43%	3,65%	5,05%
Hua nga qeveria	5,05%	4,23%	3,43%	3,65%	5,05%

Vlerat e drejta për kreditë dhe huatë afat-gjata janë si vijon:

	Vlera kontabël	
	2012	2011
Kredi dhe hua	23,148,125	24,197,629
Hua nga qeveria	13,993,014	12,798,867
TOTALI	37,141,138	36,996,496

Vlerat e drejta janë bazuar në flukset e skontuara të parasë duke përdorur një normë të bazuar në normën e kredive dhe huave prej 3,64 % p.a. (2011: 5,05% p.a.) për kreditë dhe huatë e shprehura në Euro, 3,36% p.a. (2011: 3,43% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në CHF, 3,59% p.a. (2011: 3,65% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në YEN , 3,94% p.a. (2011: 4,23% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në USD. Vlerat kontabël të kredive dhe huave afat-shkurtra janë të përafërta me vlerat e drejta.

13. Kredi dhe hua (Vazhdim)

Vlerat kontabël të kredive dhe huave të Grupit janë shprehur në monedhat e mëposhtme:

	2012	2011
Euro	35,374,331	35,368,619
US dollar	6,932,582	6,701,270
CHF	2,233,819	2,196,861
YEN	3,810,652	4,331,980
KWN	2,264,084	2,177,169
LEK	21,567,926	9,917,181
	72,183,394	60,693,080

14. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Aktivitet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë mbi fitimin kompensohen midis tyre kur ka një të drejtë të ligjshme të zbatueshme për të kompensuar aktivitet afat-shkurtër tatimore me detyrimet afat-shkurtër tatimore dhe kur tatimet e shtyra mbi fitimin lidhen me të njëjtin autoritet fiskal. Tatimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën tatimore të miratuar prej 10% (2011: 10%).

	2012	2011
Aktive të shtyra tatimore		-
Detyrime të shtyra tatimore	601,689	868,466
Detyrime të shtyra tatimore (neto)	601,689	868,466

Lëvizja bruto në llogarinë e tatimit të shtyrë mbi fitimin është si vijon:

Fillimi i vitit	868,466	858,510
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave	(266,777)	9,956
Fundi i vitit	601,689	868,466

Lëvizja në aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra gjatë vitit, pa marrë në konsideratë kompensimin e gjendjeve me juridiksion fiskal të ndryshëm është si vijon:

Detyrime të shtyra tatimore	Kredi dhe hua	Sub-vencione	Ndihma	Diferenca të porealizuara këmbimi	Maturuar	Totali
Më 31 Dhjetor 2010	858,510	-	-	-	-	858,510
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	9,956	-	-	-	-	9,956
Më 31 Dhjetor 2011	868,466					868,466
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(266,777)	-	-	-	-	(266,777)
Më 31 Dhjetor 2012	601,689					601,689

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

15. Grante

	2012	2011
Grante dhe subvencione	90,633	95,326
Shtesa gjatë vitit	64,582	16,702
Pakësime gjatë vitit		(2,194)
Axhustime riklasifikime		129,149
Amortizimi i granteve	(7,431)	(148,350)
Total	147,784	90,633

Subvencionet qeveritare lidhen me sigurimin e shërbimeve dhe aktiveve dhe mund të jenë subvencione drejtpërdrejtë nga qeveria ose nga donatorë të qeverisë shqiptare për aktivitetet e Grupit.

16. Të ardhura

	2012	2011
Energji elektrike	24,554,721	14,012,310
Shërbime	91,180	74,438
Të tjera	4,844	22,955
	24,650,745	14,109,703

17. Të ardhura të tjera operative (të ardhura të tjera nga shfrytëzimi)

	2012	2011
Të ardhura nga gjobat mbi pagesat e vonuara	2,147,914	953,549
Të ardhura nga grantet dhe shërbime të tjera	7,431	150,119
Të tjera	476,346	222,010
	2,631,691	1,325,678

18. Shpenzime personeli

	2012	2011
Shpenzime për paga	702,674	865,071
Kontribut për sigurime shoqërore	133,015	165,978
Kosto stafi të tjera	228,814	288,569
	1,064,503	1,319,618
	1.479	1.222

19. Shpenzime të tjera

	2012	2011
Shërbime të pajtuara	231,127	412,117
Mirëmbajtje	25,027	64,056
Telefon dhe postë	15,986	23,383
Shpenzime dietash për udhëtime biznesi	29,485	56,687
Komisione bankare	68,493	61,037
Tatime, taksa dhe të ngjashme	10,528	16,801
Gjoha dhe ndëshkime	192,945	598,593
Të tjera	186,512	727,090
	760,104	1,959,763

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2012

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

20. Shpenzime financiare neto

	2012	2011
Shpenzime interesi:		
– kredi dhe hua bankare	2,381,907	1,670,230
– rritje e skontimeve të periudhave të mëparshme		
Shpenzime të tjera financiare		
Fitime neto nga kursi i këmbimit në aktivitetet financiare	(1,845)	181,154
Të ardhura interesi nga kredite dhe depozitat bankare	(469,350)	(513,433)
Efekti i njohjes fillestare të detyrimeve financiare të marra jo me norma tregu	2,667,767	(99,560)
Të ardhura financiare të tjera		
Shpenzime financiare neto	4,578,479	1,238,391

21. Kreditim i tatimit mbi fitimin

	2012	2011
Tatim fitimi i llogaritur	1,038,921	3,001
Tatim fitimi i shtyre	(266,777)	9,956
	772,145	12,957

Per efekt te deklarimit në organet tatimore të dyja kompanitë (KESH Security shrsf dhe Tec Vlore sh.a.) me kapital të zotëruar 100% nga KESH sh.a. përgatisin dhe deklarojnë formularin vjetor të deklarimit të tatimit mbi të ardhurat.

Tatimi i të ardhurës para fitimit të Grupit ndryshon nga shuma teorike që do të lindë duke përdorur normën tatimore mesatare të ponderuar që zbatohet ndaj fitimeve të shoqërive të konsoliduara si më poshtë:

	2012	2011
Fitimi/(Humbja) para tatimit	7,212,212	(12,127,469)
Tatimi i përlllogaritur me 10%	721,221	(1,212,747)
Shpenzime të panjohura për efekte fiskale	317,385	161,376
Efekti nga aktivet e shtyra tatimore të panjohura	(266,456)	1,076,636
Të ardhura të patatueshme	(5)	
Përdorimi i humbjes tatimore		(12,308)
	772,145	12,957

22. Blerje energjie

Blerja e energjisë është si më poshtë:

	2012	2011
Energji e importuar	3,188,452	9,156,417
Energji e blere nga tregtarët e licensuar te energjise	4,734,941	5,435,059
Energji e prodhuar në vend nga koncesionet	2,522,782	1,007,676
Energji e prodhuar në vend nga Hec Ulëz & Shkopet, Hec Bistricë 1 & Bistricë 2, Hec Lanabregas	1,106,870	42,683
OST Disbalancat	11,541	
Energji e prodhuar në vend nga Tec Vlore		864,297
	11,564,586	16,506,132

Gjatë vitit 2012 Grupi ka importuar energji si dhe ka blerë energji nga tregtarët vendas në bazë të legjislacionit në fuqi dhe modelit të tregut të energjisë elektrike.

Sasia e energjisë e sipas burimit të furnizimit është si vijon:

	2012 (në MWH)	2011 (në MWH)
Prodhuar dhe furnizuar brenda Grupit	4,027,049	3,953,495
Energji e importuar	360,996	913,095
Energji e blere nga tregtarët e licensuar te energjise	519,749	534,737
Energji e prodhuar në vend nga koncesionet	290,505	136,832
Energji e prodhuar në vend nga Hec –et e shkeputura	397,893	67,750
OST Disbalancat	10,758	

22. Flukset e parasë nga aktivitetet operative

	2012	2011 (I Rishikuar)
Fitim/Humbja para tatimit	7,212,212	(7,359,339)
Rregullime per:		
–Amortizimin/zhvleresimet	2,000,643	1,410,446
–Renien ne vlere te AAM		221,528
– rimarrje nga rezervat	(1)	
– te ardhura nga grantet	(7,431)	(148,350)
– Te ardhura nga interesat (Shenimi 20)	(469,350)	(513,433)
– shpenzime interesi (Shenimi 20)	5,049,674	1,670,230
– fitim/humbje nga shkembimet valutore	(1,845)	181,154
– tatim mbi fitimin	(1,038,921)	(3,001)
Ndryshimet ne Kapitalin qarkullues		
– inventare	(129,375)	155,279
– llogarite e arketueshme dhe te tjera	(21,098,803)	(6,098,240)
– llogari te pagueshme dhe te tjera	641,948	4,986,645
– mjete monetare te ngurtesuara	424,784	(150,922)
Fluksi i Parase nga aktiviteti operativ	(7,416,465)	(5,648,003)

24. Transaksionet me palët e lidhura.

Grupi kontrollohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë.

Transaksionet e mëposhtme janë kryer me palë të lidhura

	2012	2011
<i>(a) Shitje mallrash dhe shërbimesh</i>		
Shitje mallrash:		42
Shitje energjie ndaj njërive shtetërore	349,430	108,952
Shitje shërbimesh:	70,030	64,284
	419,460	173,278
<i>(b) Blerje mallrash dhe shërbimesh</i>		
Njësi të kontrolluara nga shteti	1,121,160	42,683
Shoqëritë e Ujësjellësit	4,446	100,864
	1,125,606	143,546
<i>(c) Subvencione të dhena</i>		
Njësi të kontrolluara nga shteti		330,072
Demshperblim për permbytjet		285,030
	-	615,102
<i>(d) Shpërblimi i drejtuesve kryesorë</i>		
Paga dhe shpërblime të tjera afat-shkurtra për punonjësit	45,260	21,460
Këshilli Mbikëqyrës	3,248	3,956
	48,508	25,416
<i>(e) Balancat e fund-vitit me palët e lidhura</i>		
Llogari të arkëtueshme nga palët të lidhura:		
Autoritetet fiskale		410,000
Autoritetet fiskale	330,445	330,445
Autoritetet fiskale (TVSH)		773,825
Njësitë e kontrolluara nga shteti (shënimi 8)	369	369
Njësitë e kontrolluara nga shteti	254,714	79,927
	585,527	1,594,565
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë		
Dividend i pagueshëm	112,090	119,391
Të tjera	100,858	100,858
Njësi të kontrolluara nga shteti	1,467,191	633,232
Autoritetet fiskale (tatime të tjera)	28,606	403,922
Autoritetet fiskale (TVSH)	2,600,367	
Autoritetet fiskale (TVSH)	210,668	211,372
Autoritetet fiskale (sigurime shoqërore)	33,935	22,961
	4,553,716	1,491,736

24. Transaksionet me palët e lidhura. (vazhdim)

	2012	2011
<i>(f) Kredi dhe hua dhënë palëve të lidhura</i>		
OST sh.a.	12,852,844	13,167,988
	12,852,844	13,167,988
<i>(g) Kredi dhe hua nga palë të lidhura</i>		
Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë	17,981,232	14,124,977
	17,981,232	14,124,977

25. Angazhime

Angazhime ne qerane operative – kur një nga Shoqëritë e Grupit është qiramarrëse
 Grupi merr me qira zyra dhe magazina të ndryshme me marrëveshje të pa-anulueshme qiraje të zakonshme. Qiratë kanë afate të ndryshueshme, klauzola të përshkallëzimit të çmimeve dhe të drejta ri-përtëritjeje. Grupi nënshkruan kryesisht kontrata një-vjeçare të ripërtëritshme qiraje.

26. Ngjarje pas datës së bilancit

- Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr.73 dt. 30.01.2013 “Për zmadhimin e kapitalit të KESH sha” si rezultat i përfshirjes në kapital të efekteve të sistemimit të marrëdhënive me shoqëritë Hec Ulëz & Shkopet sh.a., Hec Bistrice 1 & 2 sh.a., Hec Lanabregas sh.a., si dhe sistemimit të rezervave të rivleresimit nga viti 2003 është regjistruar në kontabilitet zmadhimi i kapitalit të shoqërisë 2,704,355 mijë lekë në postin shtesë e parregjistruar kapitali, si dhe është bërë mbulimi i humbjes së vitit 2011 në shumën 12,140,426 mijë lekë. Rregjistrimi në QKR është kryer në datën 20.02.2013.
- Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr. 133 dt. 28.02.2013 “Për zvogëlimin e kapitalit të KESH sha” për vlerën e objekteve “Oficina Shkodër ” në administrim të HEC Koman, “Oficina Shkodër ” në administrim të HEC Vau i Dejës dhe objektin “Hoteli i Punëtorëve ” Bistrice në administrim të Aparatit KESH është regjistruar në kontabilitet ndryshimi i kapitalit të shoqërisë në postin pakësim i parregjistruar kapitali për vlerën 2,238 mijë lekë. Rregjistrimi në QKR është kryer në datën 09.03.2013.